



Të kuftojme dhe praktikojmë mësimin ndërkulturor në fushën e të rinjve

Manual për punonjësit rinor,
mësuesit dhe liderat e të
rinjve



Ky manual është krijuar në kuadër të projektit

"Fuqia e dialogut:

Dialogu ndërkulturor si instrument i fuqishëm për zhvillimin dhe mobilitetin e të rinjve"

Implementuar nga 4 organizatat partnere të konsortiumit nga Ballkani Perëndimor

1. Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN)
2. KREATOR Dens Kumanovo
3. AzBuki
4. InnovActive Center for Social Improvement

Me mbështetjen financiare të

Regional Youth Cooperation Office (RYCO)

Manuali u krijuar nga:

Oltiana Rama

Katerina Dimovska

Përshtatur në gjuhën angleze:

Maire Rowland



* Ky emërtim është pa paragjykim mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

MIRËNJOHJE

Ky manual do të shërbeje si dokument që mund të ndihmojë mësuesit, punonjësit social dhe të rinjtë në të kuptuarit dhe praktikuarit e mesimit dhe dialogut ndërkulturor në fushën e të rinjve.

Shprehim mirënjojje për të gjithe ata që mundesuar që ky manual të krijohej dhe të ishte i disponueshëm për këdo që mund ta gjej ndihmues në punën dhe jetën e tyre të përditshme.

Fillimisht duam të falenderojmë RYCO për besimin dhe mbështetjen në implementimin e projektit “Fuqia e Dialogut: Dialogu Ndërkulturor si Instrument i Fuqishëm për Zhvillimin dhe Levizshëmërin e te Rinjve” nga ku ky manual u krijuat dhe zhvillua.

Falenderojme 4 organizatat anëtare të konsortiumit për profesionalizmin, durimin dhe vullnetin për të bërë këtë projekt të suksesshem dhe me impakt (Projekte Vullnetare Ndërkombetare nga Shqiperia, KREATOR Dens Kumanovo nga Maqedonia e Veriut, AzBukë nga Serbia dhe Qendra për Përmiresimin Social InnovActive nga Kosova.) Eshtë e rëndësishme që organizatat bënë një punë shumë të mirë për të përfshirë 12 shkolla në projekte të tillë shkëmbimi dhe mobiliteti mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Falë tyre në patëm mundësinë të punojmë së bashku për një javë në Tiranë (2 deri me 8 Shkurt 2020) me një grup shumë produktiv dhe të dedikuar mësuesish të shkollave të mesme, punonjësish social dhe liderash të të rinjve.

Faleminderit për idete tuaja shumë të vlefshme dhe kontributin në metodat e këtij manuali:

Migjen Krasniqi, Dragana Lazerevic, Matilda Zizolli, Anita Stojchevska, Albana Janko, Blerim Sherifi, David Zivkovikj, Dafina Daka, Danijel Mišić, Dejan Kitanović, Dragana Stanković Krstić, Elena Manevska, Eglja Uka, Ermira Ymeraj, Fabiola Danaj, Getoarbë Mulliqi, Ivan Nikolić, Maja Obradović, Prespë Gashi, Rame Hajraj Suzana Petrović, Sara Mihajlovska, Ylli Thaqi.

PERMBAJTJA

Hyrje	6
Pjesa 1: Te kuptuarit e mesimit dhe dialogut nderkulturor	9
1.1.Key aspects / concepts	
#Kultura	
##Identiteti	
#Diversiteti kulturor	
#Stereotipet, Paragjykimet dhe Diskriminimi	
#Kompetencat nderkulturore	
1.2 Çfarë rezulton mësimi interkulturor?	15
#Pjesëmarrja aktive e të rinjve	
##Paqja	
#Pajtimi	
1.3. Si e arrijmë dhe praktikojmë mësimin interkulturor?	16
#Shkëmbimet rimore dhe mobiliteti	
#Bashkëpunimi regional	
Pjesa 2: Pse është i rëndësishëm mësimi nderkulturor dhe dialogu për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe cili është roli i të rinjve?	19
2.1. Pse është i rëndësishëm?	
2.2. Cili është roli i të rinjve?	
Pejsa 3: Metoda te edukimit jo-formale për të praktikuar kompetencat e mesimit nderkulturor dhe edukimin	24

Tirana, Albania



"We are superheroes, none of us
individually, but all of us together."

Hank Green

HYRJE

Pse ky manual?

Manuali eshte krjiuar per te ndihmuar punonjesit sociale, mesuesit dhe liderat e te rinteve ne te kuptuarin dhe praktikuarin e mesimit dhe dialogut nderkulturor si menrya per te kontribuar per paqen dhe pajtimin ne WB6.

Si eshte ndertuar manuali?

Manuali perbehet nga 3 pjese kryesore. Pjesa e pare ben nje permblehdje te koncepteve kryesore te elementeve te mesimit nderkulturor, paqes dhe pajtimit, me qellimin per te kuptuar temat. Pjesa e dyte prezanton nje permblehdje rrith rolit te te rinteve ne dialogun nderkulturor and pse ky rol i tyre eshte shume i rendesishem per nje rajon me te mire. Te rinteve kane aspirata, ide, energji pozitive, kapacitete dhe fuqi per te bere ndryshime.

Pjesa e fundit e ketij manuali sjelle menrya dhe ide konkrete si te perdonim disa elemente te edukimit jo formal ne praktikimin e dialogut dhe mesimit nderkulturor me te rinte. Ekzistojne shume metoda praktike si te perdonim keto elemente te edukimit ne punen me te rinte, te cilat jane shume te domosdoshme per aktivitetet ne shkolle, universitetet, grupe rinore, shkolla verore, ekskursione, piknik, shkembime rinore, seminare, mobilite, etj. Keto workshope u krijuan nga pjesemarresit e

Trajnimit per Ngritje Kapacitetesh qe u mbajt ne Shkurt 2020 ne Tirane, Shqiperi.

Pse tema e mesimit nderkulturor ne Ballkanin Perendimor 6?

Historia e shkuar dhe e tashme e Ballkanit, me ndikim ne jeten e te gjitheve ne, ka treguar se eshte e nevojshme te ndryshohen perceptimet dhe qendrimet e te rinteve ndaj fqinjve tane duke perdonur qasje interaktive dhe duke suportuar mobilitetin rinos. Stereotipet dhe Paragjykit na cojne ne diskriminim dhe urrejtje, dhe te rinteve kane nevoje te kene mundesi per te njojur dhe gjetur menrya per t'i kaluar ato. Permes te kuptuarit dhe praktikuarit te mesimit nderkulturor te rinteve behen te vetedijshem per ngjashmerite mes nesh, zhvillojne respekt ndaj te ndryshmes dhe nuk i shikojne ata si kercenime, ata fillojne te kuptojne me mire identitetin dhe kulturen e tyre dhe jane me te hapur per te eksploruar, njojur dhe pranuar kulturat e ndryshme.

Mesimi nderkulturor i con te rinteve drejt paqes dhe pajtimit. Keto koncepte jane terheqese dhe praktike, jane aspekte te perditshme per keto nga ne, te lehta per tu kuptuar dhe praktikuar nese ne rrisim te kuptuarin dhe ndergjegjesimin tek te rinte.



Permbledhje e projektit "Fuqia e Dialogut"

Projekti "Fuqia e Dialogut" promovoi dhe ndihmoi dialogun dhe mesimin nderkulturor tek te rinte, mesuesit dhe punonjesit sociale nga Ballkani Perendimor. Gjithashtu beri te mundur bashkepunime te qendrueshme mes organizatave rinore dhe shkollave te mesme ne WB6.

Projekti kombinoi aktivitete rajonale dhe lokale ne Shqiperi, Kosove, Maqedonine e Veriut dhe Serbi qe

kontribuan ne arritjen e qellimeve te ketij projekti.

Projekti kishte si target grup mesuesit, punonjesit sociale, lideret e te rinjeve, te rinje me ose pa mundesi te shumta dhe nxenesit e shkollave te mesme.

Projekti u implementua nga 4 organizata te shoqerise civile nga WB6 ne partneritet me 12 gjimnaze dhe 2 universitete, dhe me mbeshtetjen financiare te Regional Youth Cooperation Office (RYCO).

Aktivitetet kryesore te projektit u perqendruan ne:


Trajinim per 27 punonjes sociale dhe mesues ne dialogun nderkulturor dhe si mund te ndihmojme dialogun nderkulturor mes te rinjeve. Gjate trajnimit, disa elemente dhe metoda te reja ne lehtesimin e dialogut nderkulturor u krijuan dhe permblodhen ne kete manual te aksesueshem online ne Anglisht, Shqip, Maqedonisht dhe Serbisht;

Follow up (lokal): 12 workshope lokale u implementuan ne shkollat e mesme me studente dhe te rinj me me pak mundesi nga Shqiperia, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia;

Shkembim rinor per 32 nxenes dhe te rinj nga grupe te marxhinalizuar qe praktikuan kompetencat e mesimit nderkulturor, duke punuar ne nje kalendar me foto dhe slogan; nje video me mesazhe positive qe promovojne te kuptuarin kulturor, diversitetin dhe tolerancen;

Fushate online me shperndarjen e kalendarit dhe historive personale me moshataret e tyre.

Skopje, North Macedonia



"Alone we can do so
little; together we can
do so much."

Helen Keller


TE KUPTUARIT E MESIMIT DHE DIALOGUT NDERKULTUROR

1.1. ASPEKTET / KONCEPTET

Mësimi ndërkulturor i referohet përvetësimit të njohurive dhe shkathtësive që mbështesin aftësinë e nxënësve që të kuptojnë kulturën, por edhe dhe të bashkëveprojnë me njerëz nga kultura të ndryshme nga ajo e tyre.

Sipas përkufizimit, është procesi i vetëdijësimit dhe i kuptimit më të mirë të kulturës së vet dhe kulturave të tjera në të gjithë botën. Qëllimi i mësimit ndër-kulturor është të rrisë tolerancën dhe mirëkuptimin ndërkombëtar dhe ndër-kulturor, të promovojë paqen dhe bashkëpunimin midis njerëzve nga mjedise të ndryshme.

Kur dikush mund ta kuptojë mësimin ndër-kulturor, pastaj edhe dialogu ndër-kulturor është i pranishëm. Pastaj dialogu ndër-kulturor është thelbësor në parandalimin dhe përfundimin e konflikteve, promovon pajtimin dhe bashkëpunimin.



#Kultura

Pjesë integrale e mësimit ndërkulturor është të kuptuarit e kulturës dhe mënyrës se si kultura i formon individët dhe komunitetet.

Shumë prej nesh do të pyesnin se çfarë është kultura? Një mënyrë e jetës? Një grup praktikash sociale? Një sistem besimesh? Një histori e përbashkët ose një grup përvojash? Një kulturë mund të jetë sinonim me një vend, rajon, ose një komb, ose mund të kalojë disa vende ose rajone. Mund të shihet nga mikro-perspektiva, nga perspektiva individuale ose nga perspektiva e orientuar nga procesi.

Ka shumë përkufizime për kulturën, por në përgjithësi të gjithë kanë pikëpamje të përbashkët se kultura është sistemi i vlerave dhe normave që ndahen nga një grup njerëzish dhe që kur merren së bashku, përbëjnë një model të të jetuarit ku vlerat janë ide abstrakte të asaj që grupet besojnë se është e mirë ose e drejtë, e keqe ose e gabuar, dhe ku normat janë rregulla sociale dhe udhëzimet përcaktojnë sjellje të përshtatshme në situata të caktuara.

Në vitin 2002, UNESCO e definon kulturën si "një tërësi karakteristikash dalluese shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të shoqërisë ose të një grupi shoqëror, dhe që përfshin përveç artit dhe letërsisë, stilin e jetës, mënyrat e të jetuarit së bashku, sistemet e vlerave, etj. traditat dhe besimet".

Ndërsa mësimi ndërkulturor është procesi i të kuptuarit kulturor, ku së pari duhet të njihet kultura vetanake,

në mënyrë që të kuptohen, respektohen dhe pranohen kulturat e tjera.

Pra, si e kuptojmë ne kulturën tonë?: Nëse i gjen përgjigjet e pyetjeve më poshtë, atëherë do të mund ta kuptoni më mirë kulturën tuaj.

- What is defined as 'good' and 'bad' in your community?
- How are families structured?
- What is the relationship between men and women?
- How is time perceived?
- Which traditions are important?
- What languages are spoken?
- What rules govern the consumption of food and drink?

Ju mundeni gjithashtu që të bënu lulëz tuaj kulturore dhe të shihni se çfarë do të keni. Plotësoni në çdo petal me përgjigjet për veten tuaj. Shënim: Kjo fotografi mund të bëhet e njëjtë, por me ngjyra tjera dhe pozicione tjera të fjalëve;) Sygjerim për dizajnerin:D. Unë do të tha që jetë formë lulledielli, me ngjyra të ndryshme



#Identiteti

Shpesh shumë perkufizimet flasin për kulturën si një ajsberg të përbërë nga kultura të jashtme dhe të brendshme. Kultura e jashtme është majë e ajsbergut apo ajo që shihet. Këtë informacion ne e marrim nga interneti, nëpërmjet filmave apo udhëtimeve të shkurta jashtë. Por një pjesë e madhe e ajsbergut është poshtë sipërfaqes, e kjo është kultura e brendshme. Kjo përfshin vlerat, besimet dhe modelet e mendimit që ndikojnë në sjelljet tona.

Nëse ne jemi në një anije të vogël, duke ou afruar ajsbergut dhe jemi të vetëdijshëm vetëm për kulturën e jashtme, ne rrezikojmë të përplasemi. Nëse ne e kuptojmë kulturën e brendshme, ne mund të lundrojmë dhe shmangin kekuptimet dhe konflitet. Duke qenë kurioz dhe duke marrur pjesë aktivisht në dialog, ne fillojmë të kemi pamje më të mirë të pjesës tjetër të ajsbergut. Është e rëndësishme që jo vetëm të vëzhgohen kulturat e ndryshme, etnitë, nacionalitetet dhe gjinjtë, por edhe të përfshihen në mënyrë active. Ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht një kulturë tjetër pa pasur interaksion me të. Se si ju i shihni të tjerët, ndikohet nga perspektiva juaj kulturore dhe sesi të tjerët ju shohin juve, ndikohet nga e tyre. Çfarë ndodh kur flisni, a ju kuptojnë njerëzit nga kulturat e tjera në mënyrën që keni menduar? Mënyra më e lehtë për të kuptuar dikë është të flasësh me ta, të kuptosh nevojat e tyre, perspektivën e tyre dhe linjën e tyre të mendimit. Duke komunikuar dhe dëgjuar ata nga kultura të ndryshme, ne plotësojmë këto boshillëqe që mungojnë. Ne fillojmë të shohim pamjen e plotë që na lejon të përshtasim përceptimet dhe veprimet tona në përpunje me rrethanat.

Për ta përbledhur: Kultura është ajo që na formeson; ajo formon identitetin tonë dhe ndikon në sjelljen tonë. Kultura është "mënyra jonë e të qenurit".

Përkufizimi i identitetit është kush jemi, mënyra se si ne mendojmë për veten, mënyra sesi ne shikohemi nga bota dhe karakteristikat që na përcaktojnë. Dhe kur shikojmë se kush jemi, mund të njohim dy identitete. E para është identiteti personal i cili lidhet me veten. Nga ana tjetër, identiteti shoqëror që lidhet me një grup shoqëror ose koleksion grupesh. Prandaj, identiteti është diçka që evoluon, që është çdo ditë "në ndërtim e sipër". Disa pjesë të identitetit jepen nga lindja, disa riformulohen vazhdimesht përmes ndërveprimit tonë me shoqërinë, grupet, familjen. Gjithashtu, në varësi të kontekstit në të cilin jemi - ne formojmë identitetin tonë për shembull. në pyetjen se cili është identiteti juaj, ju do të prireni që fillimisht të identifikoni gjininë, nëse jeni në një dhomë të mbushur me gjini të kundërt, ose do të përmendni përkatësinë etnike nëse jeni në një grup të përzier kulturor. Pse është e rëndësishme të njihni identitetin tuaj në kontekstin e mësimit ndërkulturor? Për shkak se proceset e mësimit ndërkulturor mbështetin pjesëmarrësit për të kuptuar ndikimin e prejardhjes së tyre kulturore në zhvillimin e identitetit të tyre, në marrëdhëniet e tyre ndërnjerëzore dhe ndërkulturore. Gjithashtu, promovon që nuk ka kulturë më të mirë se tjetra, përkundrazi lejon hapësirë për të eksploruar dallimet dhe ngajshmëritë, të kuptuarit dhe pranimin e kulturave të ndryshme. Mësimi ndërkulturor udhëzon të rinxjtë të rregullojnë imazhet e tyre përgjegjësive kulturore dhe për individët që i përkasin grupeve kulturore, të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të kuptojnë të tjerët, në mënyrë që t'u ofrojnë atyre hapësirën për të manifestuar lirshëm identitetin e tyre kulturor.

Në këtë proces, ata mësojnë të përmbahen nga etiketimi i njerëzve, nga vendosja e tyre në kategoritë që ishin krijuar tashmë përpara takimit aktual.

Prandaj, është e rëndësishme të jepni hapësirë për të rinjtë që së pari të hulumtojnë identitetet e tyre dhe të kuptojnë veten e tyre, dhe më pas të mësojnë të kuptojnë kulturat e tjera, identitetet e tjera.

#Diversiteti Kulturor


Diversiteti kulturor është i rëndësishëm sepse vendi ynë, vendet e punës dhe shkollat, gjithnjë e më shumë përbëhen nga grupe të ndryshme kulturore, racore dhe etnike. Ne mund të mësojmë nga njëri-tjetri, por së pari duhet të kemi një nivel mirëkuptimi për njëri-tjetrin, në mënyrë që të lehtësojmë bashkëpunimin. Mësimi për kulturat e tjera na ndihmon të kuptojmë këndvështrime të ndryshme

brenda botës në të cilën jetojmë, dhe ndihmon që të largojmë stereotipet negative dhe paragjykimet personale për grupe të ndryshme.

Për më tepër, diversiteti kulturor na ndihmon të njohim dhe respektojmë "mënyrat e të qenurit" që nuk janë domosdoshmërisht tonat, në mënyrë që ndërsa bashkëveprojmë me të tjerët, ne mund të ndërtojmë ura për të besuar, respektuar dhe mirëkuptim përgjatë kulturave. Përveç kësak, ky diversitet e bën vendin tonë një vend më interesant për të jetuar, pasi njerëzit nga kultura të ndryshme kontribuojnë në aftësi gjuhësore, mënyra të reja të të menduarit, njohuri të reja dhe përvoja të ndryshme

Diversiteti kulturor mbështetë idenë që secili njeri mund të japë një kontribut unik dhe pozitiv për një shoqëri më të gjerë për shkak të dallimeve të tyre.

Imagjinoni një vend kur diversiteti njihet dhe respektohet; vlerësohen dhe njihen idetë e ndryshme kulturore; inkurajohen kontribuesit nga të gjitha grupet; njerëzit fuqizohen për të arrirë potencialin e tyre të plotë; dhe dallimet festohen.





#Stereotipet, Paragjykimet dhe Diskriminimi

Mësimi interkulturor synon që t'i mësojë të rinjtë me metoda të identifikimit të stereotipeve dhe paragjykimeve që vet ata ose të tjerët i kanë në sjelljet e tyre, që të kuptojnë se si funksionojnë dhe të marrin hapa të vëtëdijshëm për t'i thyer ato.

Si mundemi ne të përkufizojmë stereotipet dhe paragjykimet?

Stereotipet janë besime të përgjithshme, të mbithjeshtëzuarat ose të ekzagjera, për një grup të njerëzve. Një stereotip është 'imazh në mendjen tonë', i cili përcakton se si ne vijnë deri tek bindjet e caktuara për një person, vetëm pse ai person i përket një grupei të caktuar.

Paragjykimi është gjykimi i dikujt pa e njohur atë, në bazë të asaj se si duken. Paragjykimet janë qëndrime negative të refuzimit drejt pjestarëve të një grupei, bazuar në faktin e thjeshtë se ne i shohim si përkatësi të atij grupei. Dikush mund të ketë paragjykime kundrejt dikujt, bazuar në karakteristikat si përkatësia racore, gjinia, aftësia, etnia, nacionaliteti, feja, mosha, statusi social, orientimi seksual etj.

Stereotipet dhe paragjykimet shkojnë paralelisht së bashku. Rezultati i tyre

shpesh çon në diskriminim. Përderisa stereotipet janë struktura njohëse dhe paragjykimet janë qëndrime të bazuara në gjykime mbi vlerat, diskriminimi i referohet sjelljes. Është një sjellje e padrejtë ndaj anëtarëve të një grupei, bazar në paragjykimet që ekzistojnë ndaj atij grupei.

Diskriminimi është akti i bërjes së një dallimi të pafavorshëm për një qenie të bazar në grupin, klasën ose kategorinë të cilës ata perceptohen se i përkasin.

Duke e ditur gjithë këtë, mësimi ndërkulturor sfidon stereotipet dhe paragjykimet dhe hedh poshtë diskriminimin e çdo lloji. Mësimi ndërkulturor siguron hapësirë, mundësi dhe mjete për të mësuar për të tjerët dhe për të arritur në përfundimin se paragjykimet, stereotipet dhe diskriminimi janë të gabuara dhe ne i kapërcejjmë ato duke ndryshuar perceptimet dhe sjelljet tona.

Shumë metoda, veprimtari dhe punëtori sigurojnë hapësirë për të rinjtë që të luftojnë kundër paragjykimeve dhe stereotipeve dhe të gjejnë mënyra se si t'i tejkalojnë ato.

#KompetencatNdërkulturore

Nëse dikush merr pjesë në procesin e mësimit ndërkulturor, zhvillohen grupe të caktuara të kompetencave, të cilat quhen kompetenca ndërkulturore. Kompetenca ndërkulturore është aftësia për të komunikuar dhe sjellur në mënyra të përshtatshme me ata që janë me kultura të ndryshme dhe për të bashkë-krijuar hapësira të përbashkëta,

ekipe dhe organizime që janë gjithëpërfshirëse, efektive, inovative dhe të kënaqshme.

Ka disa njoħuri, kompetenca dhe sjellje që mund t'i përjetoni dhe zhvilloni duke marrë pjesë në disa aktivitete mësimore ndërkulturore, d.m.th. shkëmbime të tē rinjve, të mobilitetit:

- **njoħuri pér kulturën, politikën dhe historinë;**
 - **njoħuri pér tē drejtat e njeriut;**
- **njoħuri pér stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimin;**
 - **njoħuri pér dallimet kulturore;**
 - **respekt pér veten dhe tē tjerët;**
- **një ndjenjë e drejtësisë shoqërore dhe përgjegjësisë sociale;**
 - **mendje e hapur drejt diversitetit;**
 - **tolerancë dhe respekt ndaj diversitetit;**
 - **dëgjim aktiv;**
 - **aftësi pér punë ekipore;**
 - **mendim kritik;**
 - **empati ndër-kulturore;**
 - **solidaritet;**
- **trajtimi i konflikteve dhe keqkuptimeve;**

1.2 ÇFARË REZULTON MËSIMI INTERKULTUROR?

#Pjesëmarrja aktive e të rinjve

Pjesëmarrja aktive e të rinjve do të thotë që ju jeni të angazhuar ose jeni gati për t'u përfshirë në vendimmarrje dhe angazhim qytetar. Të rinjtë janë të aftësuar të luajnë një rol jetësor në zhvillimin e tyre, si dhe në atë të bashkësive të tyre, duke i ndihmuar ata të mësojnë aftësi jetësore vitale, të zhvillojnë njoħuri pér tē drejitat e njeriut dhe qytetarinë, dhe tē promovojnë veprime pozitive qytetare. Mësimi ndërkulturor inkurajon dhe çon nē pjesëmarrje aktive të të rinjve nē shoqëri. Përmes aktiviteteve ndërkonturore dhe proceseve të mësimit, të rinjtë fitojnë grupe të ndryshme aftësish, zhvillojnë të kuptuarit e temave të ndryshme dhe janë të aftësuar që të kuptojnë rolin e tyre të rëndësishëm nē shoqëri dhe të marrin rol aktiv nē shoqëri. Ata janë të motivuar të marrin pjesë nē vendimmarrje. Si rezultat i proceseve dhe aktiviteteve të mësimit ndërkonturo, ne mund t'i fuqizojmë të rinjtë me aftësi të nevojshme pér tē marrë rolin drejtues nē shoqëri dhe të arrijnë ndryshime.

#Paqja

Paqja është brenda fuqisë sonë.

Ka shumë kuptime që lidhen me paqen, kryesisht të lidhura me zgjidhjen e konflikteve pa dhunë dhe frikë. Paqja ka kuptime të ndryshme pér grupe të

ndryshme, pér rajone të ndryshme, pér mosha të ndryshme. Në kontekstin tonë rajonal paqja mund të referojë aftësinë pér tē pasur marrëdhënie miqësore, jetë nē harmoni, ta shohim njëri-tjetrin nē mirékuptim dhe dashuri, respektimi i të drejtave të njeriut, të ardhmen e përbashkët dhe bashkëpunim pér tē praktikuar paqen e brendshme, ndërtimin e pajtimit dhe solidaritetit dhe shumë më tepër. Në këtë mënyrë ne bëjmë edukim pér paqe. Sipas Kombeve të Bashkuara, edukimi pér paqe nënkupton: është procesi i përvetësimit të vlerave, njoħurive dhe zhvillimit të qëndrimeve, aftësive dhe sjelljeve pér tē jetuar nē harmoni me veten, me tē tjerët dhe me mjedisin natyror.

#Pajtimi

Pajtimi përfshin ndërtimin e marrëdhënieve paqësore nē mes të shoqërive tek të cilat nevojitet ndryshim i mentalitetit social dhe psikologjik të anëtarëve të grupeve të të dyja shoqërise, ndryshime nē motivim, synime, besime, qëndrime dhe emocione nga shumica e anëtarëve të shoqërise. Marroë (1999) i referohet pajtimit si rivendosje të miqësisë që mund tē frymëzojë besim tē mjaftueshëm nē tē gjithë ndarjen tradicionale.



1.3. SI E ARRIJMË DHE PRAKTIKOJMË MËSIMIN INTERKULTUROR?



#ShkëmbimetRinoreDheMobiliteti

Një instrument për të arritur dhe praktikuar mësimin ndërkulturor është sigurimi i hapësirës për njerëz nga kultura dhe përkatësi të ndryshme, që të mblidhen dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Për të rinjtë, kjo mund të bëhet përmes organizimit të shkëmbimeve të të rinjve dhe mobiliteteve të ndryshme, punëtorive etj.

Shkëmbimet e të rinjve lejojnë që grupe të rinjsh nga vende të ndryshme të takohen, të jetojnë së bashku dhe të punojnë në aktivitete të përbashkëta për periudha të shkurtra kohore (kryesisht 1 javë). Shkëmbimi i të rinjve sjell njerëz me

prejardhje të ndryshme, kultura të ndryshme, fe, tradita, pikëpamje të ndryshme sociale dhe politike në një vend, dhe u siguron atyre hapësirë për të jetuar praktikisht së bashku si një mundësi për të praktikuar kompetenca të të mësuarit ndërkontekst. Ata mësojnë të tolerojnë dhe respektojnë diversitetin, ta kuptojnë dhe pranojnë atë si një gjë të mirë dhe pozitive. Shkëmbimet e të rinjve zhvillohen jashtë mjedisit shkollor. Në shkëmbimin e të rinjve, të rinjtë mësojnë nga tema, nëpërmjet aktiviteteve jo-formale të të mësuarit, si: punëtori, ushtrime, debate, luajtje të roleve, aktivitete në natyrë etj.

#BashkëpunimiRegional


Ndërkombetarizimi dhe globalizimi janë bërë pjesë e brendshmë e shoqërisë tonë dhe po vazhdon të rritet rëndësia e tyre. Kontakti ynë me njerëz nga kultura të ndryshme, qoftë në vendin e punës, institucionë arsimore ose në jetën e përditshme, po rritet me shpejtësi të madhe. Për shumëkë, bashkëpunimet ndërkombe të që lidhen me punë në vend ose jashtë, janë bërë përditshmëri. Mediat ndërkombe të mbulojnë ngjarje nga e tërë bota dhe qasen me lehtësi në vendet që kanë distancë gjeografike dhe kulturore. Në nivel global është më shumë se e qartë se të gjithë ne jemi të ndryshëm.

Por, në nivel regional, kur i sheh regionet në botë, a mund të vini në përfundim se njerëzit e një regjioni janë mjaft të ngajshëm? Por edhe pse ne jemi në rritje të ndërlidhjes, vazhdojmë të dallojmë për nga kultura. Ne kemi kultura të ndryshme

dhe flasim gjuhë të ndryshme. Të marrim si shembull 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Edhe pse ne kemi shumë gjëra të përbashkëta, kulturat tona janë të ndryshme. Mësimi ndërkulturor çon kështu tek njohja e kulturave tjera dhe tek aftësia për të bashkëpunuar, dhe puna me kultura tjera çon tek bashkëpunimi më i mirë regional, duke vazhduar kështu edhe tek bashkëpunimi më i mirë ndërkombe tar. Prapë marrim shembull 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, ku ne kemi shumë gjëra të përbashkëta, por akoma janë të pranishme shumë paragjykime dhe stereotype, jemi afér dhe larg në të njëjtën kohë. Mësimi ndërkulturor kështu mund të çojë drejt thyerjes së paragjykimeve dhe stereotypeve, përfundimit të urrejtjes, përfundimit të diskriminimit dhe ndërtimit të një rajoni më të mirë që mund të përballojë dhe të integrohet në botën globale



Sarajevo, Bosnia and Herzegovina



“You never really know a man
until you understand things
from his point of view, until
you climb into his skin and
walk around in it.”

Harper Lee



PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM MËSIMI NDËRKULTUROR DHE DIALOGU PËR 6 VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE CILI ËSHTË ROLI I TË RINJVE?

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Ballkani është i zhytur në diversitet kulturor, dhe dialogu ndërkulturor është një mjet që na lejon të bashkëpunojmë. Rezultatet e Gallup Balkan Monitor tregojnë se midis 80-90% të njerëzve në rajonet e Ballkanit Perëndimor besojnë se për paqen dhe zhvillimin e mëtejshëm në rajon, është e nevojshme lëvizja e lirë e njerëzve dhe më shumë bashkëpunim. Për më tepër, midis 40-60% dëshirojnë lidhje më të forta midis njerëzve të rajonit. Sidoqoftë, njerëzit u shprehën se ndjehen gjithnjë e më të huaj nga njëri-tjetri dhe më pak të ngjashëm. Konfliktet e kaluara kanë krijuar rezerva dhe besime të rreme për kulturat dhe etnitë e tjera. Edhe nëse këto çështje janë më shumë politike, ato paraqiten në aspektin social, duke ndikuar

në perceptime, e si rezultat edhe në marrëdhëniet ndërkulturore. Kur mbajmë rezerva për të tjerët, kjo na pengon të gjejmë mundësi të reja, miqësi, partneritete dhe të punojmë së bashku për një të ardhme më të mirë.

Diversiteti kulturor është treguar se rrit aftësitë e zgjidhjes së problemeve, krijimtarinë dhe inovacionin. Me këto fakte kemi motivim për larmi kulturore, dhe tanë e vetmja sfidë është të sigurojmë që njerëzit kanë aftësinë të komunikojnë mirë së bashku. Duke praktikuar dialog ndërkulturor, ne fillojmë të ndërtojmë ura, të punojmë së bashku dhe të kuptojmë idetë dhe perspektivat e njëri-tjetrit, të cilat në fund mund të na bëjnë të ndjehemi më të lidhur.

Dialogu ndërkulturor, ndër të tjera, është një rrugë drejt paqes. Sfida më e rëndësishme në shoqëri është që njerëzit me prejardhje të ndryshme të jetojnë së bashku në harmoni. Për të ndërtuar një rajon harmonik, duhet të jetojmë së bashku me dallimet tona, dhe për ta bërë këtë duhet të mësojmë të ecim në këpucët e të tjerëve, të shohim të tjerët nga sytë e tyre.

Duke u angazhuar në dialog të sinqertë dhe duke mbajtur një mendje kurioze ne mund të mësojmë nga njëri-tjetri, të zbusim tensionet në të ardhmen dhe në fund të fundit të krijojmë një botë më empatike dhe paqësore.



Përfitimet për Ballkanin Perëndimor 6 mund të janë të mëdha:

- Shmangim marginizimin e qytetarëve
- Kuptojmë dhe mësojmë nga ata që nuk e shohin botën ashtu si ne.
- Vetë-zbulimi dhe zhvillimi
- Mundësi dhe miqësi të reja
- dentifikimi i ngashmërive dhe dallimeve në kultura
- Shmangim konfliktet dhe kuptojmë që mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me dhunë
- Promovimi i kohezionit social
- Mblidhen njerëzit së bashku
- Nxitje e paqes dhe pajtimit

2.2. CILI ËSHTË ROLI I TË RINJVE?

Para së gjithash, të rinjtë duhet që në mënyrë aktive të marrin pjesë në dialogun ndërkulturor. Tani kemi kuptuar "çfarë dhe pse", por çfarë të themi për "ku dhe si"? Disa dialogje mund të vijnë natyrshëm, kjo është lehtësish e qetë dhe mund të ndodhë pa një proces mendimi. Sidoqoftë, dialogu midis atyre që kanë pikëpamjet më divergjente dëshmojnë të janë më të vështirat, por më kritiket.

Dialogu duhet të ndodhë në një hapësirë të sigurt, ku të gjithë ndjehen të qetë, ku mund të flitet lirshëm, por gjithashtu mund të largohet dikush nëse është e nevojshme. Është e rëndësishme që kjo të jetë e vërtetë për të dy palët, pasi dialogu nuk është dialog nëse nuk bazohet në barazi.

Pra, si mund të përfshihet rinia në një dialog të tillë? Çfarë mund të bëjnë të rinjtë për të arritur dialog ndërkulturor dhe përvojë të mësimit ndërkulturor? A është proces i thjeshtë apo kërkon kohë?



Këtu janë disa rekomandime se si mund të angazhohen të rinxjtë:

Gjeni një bazë të përbashkët, për çudi, edhe me kaq shumë njerëz të ndryshëm në të gjithë botën, ne gjithmonë mund të gjejmë ngjashmëri tek ta. Të gjithë kanë hobi, frikë, dëshirë dhe ëndërr. Para se t'u qasemi dallimeve tona, së pari është e rëndësishme të vendosim atë që na lidh. Mund të përdorim edhe forma të tjera si muzikë, sport, grafite ose koncerte;

Jini kuriozë dhe dëgjoni. Mjeti më i rëndësishëm për të kuptuar dhe mësuar është kurioziteti. Dëgjoni me kujdes të tjerët; mësoni, rriteni dhe zgjeroni mendjen tuaj. Merre parasysh informacionin që po merr dhe mos dëgjo vetëm për tu përgjigjur;

Jini të hapur dhe empatikë. Është e zakonshme të dëgjoni ide dhe bindje që bien ndesh me tuajat. Duke dëgjuar të tjerët dhe duke parë perspektivën e tyre, ne nuk jemi duke minimizuar idealet tona, por duke zgjeruar aftësinë tonë për empatitë dhe simpatitet;

Mundohuni të përcaktioni se ku kulturën tuaj ka formuar mendimin tuaj. Është e rëndësishme të identifikojmë kulturat tona dhe se si ato formojnë idetë tona. Duke bashkëvepruar me një kulturë tjetër, ne kemi mundësinë që ta provojmë kulturën tonë nga sytë e një tjetri dhe të reflektojmë përfekt që ai ka pasur në idealet tona. Është e rëndësishme të theksohet se duke identifikuar kulturën tuaj nuk po përpikeni ta ndryshoni atë, thjesht po mbeten të vetëdijshëm për ekzistencën e saj;

Mos harroni se dialogu është një proces dhe jo i bazuar në një rezultat neto. Mos i nxirr rezultatet me forcë. Lejoni që biseda të lindë natyrshëm dhe shihni se çfarë ndodh me kohë;

Njih kultura të tjera, udhëtoni jashtë vendit, eksploroni;

Bisedo për diversitetin me miqtë tuaj, familjen tuaj, fqinjët tuaj, pranimin, tolerancën, ndani me ta ato që të reja që keni mësuar dhe si kanë ndryshuar perceptimet tuaja pas një përvje të veçantë;

Merrni pjesë në shkëmbime të të rinjve, takoni njerëz të rinj dhe bëni miq të rinj;

Eksploroni, njihni veten tuaj, njohni paragjykimet tuaja dhe përpinquni t'i zvogëloni ato duke lexuar fakte, të dhëna, duke takuar njerëz;

Dialogu ndërkuitorur është gjithashtu një udhëtim i vetë-zbulimit. Nëse mënyra juaj e të menduarit nuk është kurrë në kundërshtim me rrëthinën tuaj, nuk keni pse të përshtateni. Nëse nuk lini kurrë zonën tuaj të rehatisë, si mund të mësoni? Duke mësuar për të tjerët, ne fillojmë të shohim format që kultura jonë ka bërë për ne. Ne fillojmë të shohim një identitet kulturor dhe një prapavijë që mund të ketë formuar besimet dhe vlerat tona. Kjo çon në një zhvillim të vetëdijes dhe na lejon të rritemi;


Mendoni në mënyrë kritike;

Kini kujdes nga lajmet e rreme dhe mediat sociale që përhapin urrejtje dhe përçarje midis shoqërive;

Bëni punë vullnetare për komunitetin tuaj lokal, në lagjet tuaja, në rajon dhe më gjërë. Kjo do t'ju ndihmojë të mbushni zemrën tuaj me mirëkuptim, të zhvilloni aftësi të buta, të përmirësoni jetën e komunitetit dhe jetën tuaj, kjo do t'ju ndihmojë të bëni miq përgjithmonë;

Besoni në veten tuaj.

Shkëmbimet rinore dhe lëvizshmëria bëjnë të mundur "prekjen" e disa ose të gjitha përfitimeve të përmendura më lart.



Ne të gjithë jemi udhëheqës dhe të gjithë kemi sfera të ndikimit. Qoftë në shkolla, kisha, xhami, komunitete apo organizata të tjera. Rinia është gjenerata tjetër e krijuesve të ndryshimeve. Duke biseduar me të tjerët me të kaluar, fe dhe kulturë të ndryshme, ne jemi duke mësuar të shohim gjérat nga perspektiva e tyre dhe ne jemi të motivuar të ndërmarrim veprime në emër të tyre, dhe ata në tonën.

Të gjithë ne kemi aftësinë të mbrojmë grupe, fe, etni dhe kultura të tjera. Ne mund ta bëjmë këtë duke i inkurajuar të tjerët të marrin pjesë në përvojat e mësimit ndërkulturor dhe të ndajnë atë që kemi mësuar në mënyrë që edhe të tjerët të mund të kenë përfitme.

Të rintjtë kanë fuqinë të ndikojnë tek mësuesit, prindërit dhe bashkëmoshatarët, të ndihmojnë në prishjen e narrativave negative të së kaluarës dhe krijimin e një shoqërie më të lidhur, dhe përfundimisht një botë më paqësore.

Besimi dhe respekti i ndërsjellë midis shoqërive tona do të krijojë zërin e paqes për të ardhmen.

Belgrade, Serbia



"Reconciliation is
more beautiful
than victory."
Violeta Chamorro

Pristina, Kosovo



"Young people can play a crucial role in advancing intercultural dialogue and cross-cultural understanding and they can help shape the social, economic, political and cultural life of their communities and their countries."

United Nations

METODA TE EDUKIMIT JO-FORMALE PËR TË PRAKTIKUAR KOMPETENCAT E MESIMIT NDËRKULUROR DHE EDUKIMIN PËR PAQEN

Në pjesën vijuese do të paraqesim 12 metoda, të cilat u sugjeruan nga pjesëmarrësit dhe ekipi i trainerëve dhe fasilituesve në një trajnim për ndërtimin e kapaciteteve të zhvilluar në Tiranë. Secila metodë siguron informacione se cilat janë objektivat e aktivitetit dhe cilat kompetenca do të zhvilloni përmes saj, cili është grupi i synuar dhe sa pjesëmarrës mund të marrin pjesë në të. Ekziston një përshkrim i detajuar i aktiviteteve dhe pyetjeve të propozuara për

diskutim si pjesë e seminarit. Varet nga mësimdhënësi ose lehtesuesui që gjithashtu të modifikojë workshopin në kontekstin e grupit të cilit i drejtohet.

Gjithashtu, disa workshope u implementuan si aktivitete vijuese në shkolla në Shqipëri, Maqedonin e Veriut, Serbi dhe Kosovë. Të gjithë ata vërtetuan se ishin interesantë për studentët, njallin diskutime dhe motivojnë studentët dhe të rinjtë të flasin, mendojnë dhe nxjerrin përfundime.

Podgorica, Montenegro



“Not one of us can rest, be happy, be at home, be at peace with ourselves, until we end hatred and division.”

John Lewis

A MUND TË MË PËRKUFIZONI MUA?

Kompetenca e adresuar:

Identiteti, Kultura, Paragjykimet dhe Stereotipet

Madhësia e grupit:

8-20 pjesmarrës, mosha 14 – 20

Koha e nevojitur: Maksimumi 1 orë

Objektivat e punëtorisë:

